



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 45, datë 01/10/2004

**“PËR KALIMIN KAPITAL TË NJË AUTOVETURE
NJËSISË BASHKIAKE NR.9, TIRANË”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës në mbledhjen e tij të datës 01/10/2004, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës “Mbi kalimin kapital të një autoveture Njësise Bashkiake Nr.9, Tiranë”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në VKM Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin kapital të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore” pika 2, gërma ç dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I;

1. Të bëhet kalimi kapital, nga Bashkia e Tiranës në Njësinë Bashkiake Nr.9 Tiranë, i autoveturës me të dhënat si më poshtë vijon:
 - Targa: TR 2686 E
 - Marka: Volkswagen
 - Tipi: Golf
 - Lloji: Veturë
 - Nr. Shasisë: W V W Z Z Z 19 Z E B 412899
 - Viti i prodhimit: 1985
 - Ngjyra: Jeshile
 - Vlera e autoveturës (mbas amortizimit): 298.525 lekë
2. Ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike, Drejtoria e Financës dhe Njësia Bashkiake Nr.9 Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI